Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0029

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "DESHISHKU GB" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "KOMUNA GLLOGOC" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Intervenimet Emergjente Ri-tenderim (10,000.00 për vitin 2023, 10,000.00 për vitin 2024, 10,000.00 për vitin 2025)" me numër të prokurimit 611-23-11243-2-2-1, me 29/03/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Deshishku GB" SH.P.K, me nr. 2024/0029, e datës 09/01/2024, kundër vendimit të AK /Komuna Gllogoc, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Intervenimet Emergjente Ri-tenderim (10,000.00 për vitin 2023, 10,000.00 për vitin 2024, 10,000.00 për vitin 2025)" me numër të prokurimit; 611-23-11243-2-2-1.

2. Anulohet "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues"për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër të prokurimit: 611-23-11243-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna Gllogoc, dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.10.2023, Komuna Gllogoc në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Intervenimet Emergjente Ri-tenderim (10,000.00 për vitin 2023, 10,000.00 për vitin 2024, 10,000.00 për vitin 2025)" me nr. të prokurimit: 611-23-11243-2-2-1. Ndërsa me datën 26.10.2023 ka publikuar B12 Proces verbali i hapjes se Tenderëve për shpërblim me kontratë OE "Luigj Kastrati B.I".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 30,000.00 €.

Me 26.12.2023, OE "Deshishku GB" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 28.12.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën si të pabazuar.

Me 09.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Deshishku GB" SH.P.K., me nr. 2024/0029 për lidhur me aktivitetin "Intervenimet Emergjente Ri-tenderim (10,000.00 për vitin 2023, 10,000.00 për vitin 2024, 10,000.00 për vitin 2025)" me nr. të prokurimit: 611-23-11243-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "DESHISHKU GB" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi yne ankimor ka te beje me diskriminimin e vazhdushem qe Autroiteti Kontraktues: Komuna Gllogoc po bene ndaje neve si OE: DESHISHKU GB SH.P.K., ne vazhdim ju araqesim faktet dhe argumentet;AK me date: 03.11.2023 ka shperblyer me kontrate OE: Luigj Kastrati B.I., ndersa neve si OE: DESHISHKU GB SH.P.K. na ka eliminuar edhe pse kemi qene me cmim me te ulet, ne kete vendim kjo ka qene arsyja e eliminimit: I mungojne referencat dhe kontrata te natyres se ngjajshme. Ne me date: 08.11.2023 kemi bere kerkese per rishqyrtim, pergjigjjen per rishqyrtim ekemi pranuar me date: 09.11.2023 - ne kete pergjigjje eshte cilesuar si e pa paze kërkesa jone per rishqyrtim, ndersa ne kete pergjigjje jane shtuar dhe ndryshuar arsyjet e eliminimit, keto kane qene arsyjet e elminimit: 1. Ju mungojne kontratat e natyres se ngjajshme si pase DT dhe Njoftimit per kontrate perkatesisht natyren lidhur me dizenfektim; 2. Dhe ju mungon te paisjet - Pompa per dizenfektim. Ne me date: 20.11.2023 kemi paraqitur ankese ne OSHP me numer te protokolit: 925/23, me date: 11.12.2023 kemi pranuar raportin e Ekspertit shqyrtues, raporti ne fjale i ka dhene baze te plote ankeses tone, dha ka cilesuar qe ne si OE i plotesojme kerkesat e DT, ne kete raport Eksperti i ka dhne verejtjet ndaj AK per menyren e ndryshimit te arsyjeve te eliminimit. AK me date: 21.12.2023 ka shperblyer prape me kontrate OE: Luigj Kastrati B.I., AK kete vendim e ka bere pa e pritur Vendimin e PSH nga OSHP, pa e ditur a jemi pajtur ne si OE me raportin e Ekspertit shqyrtues, dhe pa e anuluar venimin e dates: 03.11.2023 - ashtu siq ka rekomanduar Eksperiti shqyrtues.Ne vedimin e dates 21.12.2023 AK prape i ka ndyshuar arsyjet e eliminimit, kjo eshte arsyja e elmiminit: Ne pozicionet 3 dhe 13 cmimet jane anorme te larta krahasuar me cmimet e tregut.AK nuk na ka derguar leter standarte per te arsyetuar-shtjelluar cmimet ne pozicionet 3

dhe 13, te njejtit nuk e kane hulumtuar tregun dhe nuk kane ofruar asnje argment qe tregon qe cmimet tona jane te larta.Siq shihni edhe me larte ne cdo vendim apo pergjigjje te AK i kane ndryshuar arsyjet e elminimit, te gjitha i konsiderojme te pa paza. Ne me date: 21.12.2023 kemi kerkuar qasje ne dukometacion te OE: Luigj Kastrati B.I., kemi kerkuar vetem paramsen me cmime - e njeta na eshte derguar me date: 22.12.2023, ne cmimet e OE ne fjale kemi verejtur se pozicionet 1 dhe 2 kane cmime abnormalisht te ulta ne krahasim me punen qe duhet te behet ne keto pozicione, cmimet qe jane te vendosura nuk munden te mbulojne ase koston e transportit te personelit e lere me shpenzimet e tjera, siq jane: Meditjet e personleit, derivatet e makinerise, klor, etj. Poashtu edhe ne disa pozicione te tjera kemi verejtur qe ka cmime me te ulta sa sa cmimet e tregut dhe ne disa pozicione tjera ka cmime me te larta se cmimet e tregut.Ne me bindje te plote konsiderojme qe cmimet tona nuk jane te larta, jane cmime te tregut, poashtu pozicionet 3 dhe 13 nderlidhen edhe me pozicione tjetra dhe ekzekutohen cdo here bashkarishte. Ne konsiderojme qe jemi eliminuar padrejtesisht nga AK, andaj kerkojme nga ana juaj si Organ Shqyrtues i Prokurimit te veproni ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 12.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0029/24, ndërsa me datë 25.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0029 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Vlerësimi i pretendimeve të OE "DESHISHKU GB" SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0029 si në vijim:

Përgjigje ne pretendimin ankimor 1: "Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pa kënaqur me vendimin e AK-se te datës: 21.12.2023, ka parashtruar ankese me pretendimin se AK-ja nuk po i respekton procedurat e vlerësimit te ofertave sipas dispozitave te nenit 59 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron për Panelin shqyrtues, se për ketë aktivitet të prokurimit, është hera e dyte qe OE ankues dorëzon ankese (925/23) pran OSHP-se, për të cilën konform nenit 113 dhe 114 të LPP-se, e kam dorëzuar raportin e ekspertizës.

Vlen të përmendet se AK-ja, nuk e ka pritur vendimin e PSH-se po ka vazhduar për rivlerësimin e ofertave, me c'rast përsëri e ka rekomanduar për kontrate të njëjtin operator ekonomik, ndërsa OE ankues e njofton me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar.

Në letrën standarde të tenderuesit të eliminuar AK-ja, ndryshe nga hera e pare, AK-ja e evidenton pozicionin nr. 3 dhe 13 të paramases se OE ankues ka ofruar si çmime të larta ne raport me çmimin e tregut.

Eksperti shqyrtues bazuar ne dispozitat e nenit 61 të LPP-së dhe rregullores për çmime jo/normalisht të ulëta, vlerëson se AK-ja nuk i ka respektuar dispozitat e parapara ne nenin 61 të LPP-së dhe rregulloren për çmime jo /normalisht te ulëta për faktin se gjate ekzaminimit ne platformën e E-Prokurimit nuk kam vërejtur se AK-ja i ka dërguar letrën standarde për sqarim te

çmimit dhe ky veprim i AK-se konsiderohet shkelje procedurale gjatë vlerësimit të ofertave.

OE ankues gjithashtu pretendon se edhe i rekomanduari ka ofruar çmime jo/normalisht të ulëta ne disa pozicione, për të cilat eksperti shqyrtues vlerëson se gjate rivlerësimit AK-ja duhet ti zbatoj ne tërësi dispozitat e nenit 61 të LPP-së dhe rregulloren për çmime jo/normalisht të ulëta, konkretisht te veproje në përputhje me nenin 4 te rregullores për çmime jo/normalisht të ulëta – Procedurën Inter Partes."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Deshishku GB" SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Deshishku GB" SH.P.K., janë të bazuara.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit

mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit ekonomik ankues"Deshishku GB" SH.P, janë vlerësuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore për prokurim publik, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e "Intervenimet Emergjente Ri-tenderim (10,000.00 për vitin 2023, 10,000.00 për vitin 2024, 10,000.00 për vitin 2025)" me nr. të prokurimit: 611-23-11243-2-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Deshishku GB" SH.P.K., dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Deshishku GB" SH.P.K, janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Intervenimet Emergjente Ri-tenderim (10,000.00 për vitin 2023, 10,000.00 për vitin 2024, 10,000.00 për vitin 2025)" me nr. të prokurimit: 611-23-11243-2-2-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin, faktet e lartë përmendura, ankesën e operatorit ekonomik ankues, dokumentacionit të lëndës, pas analizimi te tyre e vlerëson ankesën e operatorit si të bazuar, duke vendosë që aktiviteti i prokurimit me titull "Intervenimet Emergjente Ri-tenderim (10,000.00 për vitin 2023, 10,000.00 për vitin 2024, 10,000.00 për vitin 2025)" , të kthehet në Rivlerësim dhe obligohet Autoriteti kontraktues, të veproj për evitimin e gjitha shkeljeve ligjore, përkatësisht të pretendimeve ankimore të OE ankues, të vlerësuara si të bazuara/qëndrueshme sipas Raportit të ekspertit shqyrtues, konstatime të cilat janë të mbështetura nga Paneli shqyrtues, me dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues vrenë se palet e njejta, për të njëtin aktivitet të prokurimit kanë paraqitë ankesë në OSHP me numer 925/2023 dhe Paneli ka marr me 16.02.2024, ka marr vendim procedural për perfundimin e procedures ankimore, bazuar në pajtimin e tyre me raportin e ekspertit shqyrtues, të deklaruar në sistemin e-prokurimi, nga Autoriteti kontraktues dhe Operatori ekonomik.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat

dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA GLLOGOC**
- OE - **DESHISHKU GB SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: